



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

Nr. 17, Datë 16/01/2023

“Për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 (një) vend vakant për anëtar i Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për këtë vend vakant”








Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm nr. 30, datë 07.12.2022, i Rektorit të UT-së, “Për fillimin e procedurave të aplikimit dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për anëtarin e Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e UT-së”, si dhe Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, si dhe pikës 6 të Vendimit nr. 782, date 26. 12. 2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe Vendimit nr. 15, datë 19.12.2022, “Për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar i Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e UT-së”, i KIZ-it të UT-së, si dhe “Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, në Republikën e Shqipërisë, nr. 80, datë 22.07.2015, Neni 48, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4673/3 prot., datë 29.09.2022.



VENDOSI:

1. Propozimin e shtyrjes së pranimit të kandidaturave për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar i Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e UT-së dhe rifillimin e procesit të vetëkandidimit për këtë vend vakant, për arsye të mospërbushjes së mundësisë së përzgjedhjes nga tri kandidatura, sipas pikës 6 të Vendimit nr. 782, datë 26. 12. 2018, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë.
2. Vendimi dërgohet për zbatim në Rektoratin e UT-së dhe në Senatin Akademik të UT-së.
3. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e UT-së dhe në faqen e tij zyrtare.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|---|
| 1. Edvin Lame | (Kryetar) |  |
| 2. Xhensila Kadi | (Anëtare) |  |
| 3. Alnida Koroshi | -//- |  |
| 4. Shaniko Allajbeu | -//- |  |
| 5. Arjan Tushaj | -//- |  |
| 6. Eljon Doçe | -//- |  |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- |  |

